

1 E martë, 10 maj 2022

2 [Paraqitje e mëtejshme]

3 [Seancë e hapur]

4 --- Fillon në orën 14.00

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve brenda
6 dhe jashtë sallës së gjyqit.

7 Znj. Sekretare, ju lutem a mund të thërrisni çështjen.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 mirëdita. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
11 Selimit dhe z. Jakup Krasniqit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
13 Sekretare.

14 Tani ju lutem palëve që të prezantohen, duke filluar me
15 Zyrën e Prokurorit.

16 Z. Prokuror.

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës
18 dhe mirëdita të gjithëve. Nga Zyra e Prokurorit të
19 Specializuar është Alan Tieger dhe Dounia Hattabi [sipas
20 përkthimit].

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Tani Mbrojtja për z. Krasniqi.

23 Znj. Alagendra.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, znj.

25 Alagendra, përfaqësuese e z. Krasniqi. Së bashku me mua janë

1 Aidan Ellis, bashkëmbrojtës. Viktor Beqiri, Mentor Beqiri dhe
2 gjithashtu Laura Abia.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përshëndetje.

4 Tani më lejoni t'i jap fjalën avokates për viktimat

5 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Përshëndetje, unë jam
6 bashkëavokate dhe përfaqësoj viktimat në këtë çështje.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Tani le t'i
8 kthehemi Zyrës së Administrimit.

9 Z. Nilsson.

10 Z. NILSSON: [Përkthim] Përshëndetje të gjithëve. Unë jam
11 z. Nilsson. Jam përfaqësues i Zyrës Administrative sot.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Nilssen.

13 Dhe së fundi, për procesverbal them që z. Krasniqi është
14 këtu i pranishëm në sallën e gjyqit.

15 Me 3 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë për
16 ndryshuar aktakuzën në pajtim me rregullën 90(1)(b). ZPS-ja
17 paraqiti tre kategori të ndryshimeve.

18 Kategoria e parë përbëhet nga dy vende ndalimi në
19 Suharekë, në komunën e Suharekës në lidhje me anëtarët e UÇK-
20 së dhe që kanë të bëjnë me përndjekjen, me burgimin, me
21 ndalimin arbitrar dhe trajtime të tjera çnjerëzore ose mizore,
22 torturë, vrasje dhe zhdukje me forcë.

23 Kategoria e dytë ka të bëjë me dy incidente të
24 persekutimit dhe vrasjes të kryer në Gjilan në komunën e
25 Gjilanit dhe ndryshimin e kornizës kohore për vendin e

1 ndalimit në Gjilan.

2 Kategoria e tretë përbëhet prej dy incidenteve me
3 pjesëmarrjen personale të të akuzuarit në krimet e akuzuara.

4 Me datë 23 dhjetor 2021, unë nxora vendimin e parë me
5 kërkesë të ZPS-së në të cilin unë i dhashë ZPS-së të drejtën
6 që të ndryshonte aktakuzën lidhur me kategorinë e tretë të
7 ndryshimeve të propozuara të cilat unë i konsideroj që nuk
8 përbëjnë akuza të reja.

9 Më tej, konstatova se kategoritë e para dhe të dyta
10 përbëjnë akuza të reja dhe si rezultat do të duhet të
11 vlerësohen përkundrejt pragut të nevojshëm provues si dyshim i
12 mirëbazuar, siç parashikohet rregullën 86(4) të Rregullores
13 dhe në dritën e provave të parashtruara sipas rregullës 86(3)
14 të Rregullores.

15 Palët janë të urdhëruar që të dorëzojnë përgjigjet e tyre
16 dhe kundërpërgjigjet mbi çështjen në qoftë se materiali
17 mbështetës për ndryshimet konsiderohet si akuzë e re dhe në
18 qoftë se mbështetet në dyshimin e mirëbazuar në pajtim me
19 rregullën 86(4) të Rregullores.

20 Më 22 prill 2022, kam konfirmuar kategorinë e parë dhe të
21 dytë të ndryshimeve dhe akuzat kundër të akuzuarve. Kam
22 urdhëruar gjithashtu ZPS-në që të dorëzonte deri të premtën,
23 29 prill 2022, një aktakuzë të ndryshuar me ndryshimet e
24 kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë.

25 Me 22 prill 2022, ZPS-ja ka parashtruar aktakuzën e

1 ndryshuar, një version më pak të redaktuar dhe versione të
2 redaktuara publike të kategorisë së parë, pra të përmbledhjes
3 shkresore provuese të kategorisë së parë dhe gjithashtu edhe
4 një version konfidencial dhe të redaktuar publik, për sa i
5 takon përmbledhjes së dytë për këtë kategori.

6 Më 2 maj 2022 kam planifikuar paraqitjen e parë.

7 Më lejoni që të shpjegoj pak qëllimin konkret të kësaj
8 paraqitjeje vijuese për përfitim të të akuzuarit dhe atyre që
9 na ndjekin në galerinë publike dhe online.

10 Më lejoni të theksoj që procesi i sotëm nuk është gjykim.
11 Nuk do të parashtrohen prova si dhe nuk do të diskutohet për
12 fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit.

13 Qëllimi i paraqitjes së mëtejshme rregullohet nga neni 39
14 i Ligjit dhe rregullat 90 dhe 92 të Rregullores.

15 Në pajtim me këto dispozita, si Gjykatës i Procedurës
16 Paraprake, do të kërkoj leximin e akuzave në aktakuzën e
17 ndryshuar të konfirmuar; do të konfirmoj që i akuzuari i
18 kupton akuzat e reja; do të bindem që të drejtat e të
19 akuzuarit, në veçanti e drejta e tij për përfaqësim nga
20 mbrojtësi janë të respektuara; dhe do të informoj të akuzuarin
21 që brenda 30 ditëve nga dita e sotme atij do t'i kërkohet që
22 të vetëdeklarohet për fajësinë ose pafajësinë në lidhje me
23 secilën prej akuzave të reja të cilat janë shtuar në aktakuzën
24 e ndryshuar.

25 Në qoftë se i akuzuari dëshiron ta bëjë këtë gjë, ai mund

1 të shprehet menjëherë lidhur me fajësinë ose pafajësinë e tij.

2 Pres që palët t'i respektojnë këto çështje të cilat unë
3 do t'i marr njëra pas tjetrës.

4 Së pari, a mund t'ju pyes z. Krasniqi të konfirmoni që
5 keni marrë një kopje të aktakuzës së konfirmuar që mban datën
6 29 prill 2022?

7 I AKUZUARI KRASNIQI: I nderuari Gjyqtar, zonja dhe
8 zotërinj të të gjithave segmenteve të drejtësisë që jeni të
9 thirrur të mbronni dhe të bëni drejtësi, kërkoj që të më
10 kuptoni drejt. Gjatë të gjithë jetës time kam qenë njeri me
11 integritet, në mënyrë më të qartë në raport me më fortin.

12 Por, për më të dobëtin kurrë nuk kam shfaqur as shenja
13 egërsie e as përbuzje, veç dhembshurisë njerëzore.

14 Padrejtësisë, sado e rrezikshme që ishte dhe është edhe
15 sot, se është nisur nga e njëjta logjikë që e kam jetuar në
16 Jugosllavi, nuk i jam përgjigjur me heshtje asnjëherë. Sot po
17 i them vetëm pak fjalë.

18 Mbase jam gabim, por kurrë nuk kisha besuar sikur të mos
19 të ishte ky rast, se juristë të shkolluar në vendet me
20 demokraci liberale, me traditë që pretendojnë se punojnë në
21 një sistem të drejtësisë kredibile, për të bërë drejtësi
22 standarde, guxojnë të ngritin një akuzë që mbështetet vetëm e
23 vetëm mbi bazën e gënjeshtreve të Serbisë dhe e cila cenon
24 rëndë jetën, lirinë e të drejtën e individit dhe jo vetëm të
25 individit. Madje ja godet tepër rëndë, e godet në palcë të

1 kurrizit të drejtën e një populli për liri e shtetndërtim me
2 një padrejtësi të madhe.

3 Mua më vjen turp se pse po jetoj në këtë kohë të këtij
4 lloji homosapiensi që me kaq lehtësi jua shkatërron jetën
5 njerëzve dhe familjeve që guxuan të luftojnë për jetën në
6 liri, për demokracinë e pavarësinë, një regjim tepër, ndër më
7 kriminelët e pasluftës së dytë botërore.

8 Madje në atë kohë nuk besoj se në botë ka pasur një
9 regjim të tillë kriminal e gjenocidal sa e si ishte regjimi i
10 Milosheviqit, të cilit nuk po i mungon as qimja e flokut.

11 Unë mund t'ju them thotë Sokrati në shekullin e katërt
12 para erës sonë se "nga pasuria nuk lind virtyti, por është
13 pikërisht virtyti prej të cilit lind çdo e mirë e begati si
14 për individin ashtu edhe për shtetin". Për kohën tonë, unë do
15 të thosha, unë mund t'ju them se nga ajo që kam parë gjatë
16 jetës time politike, pse dikush mund të jetë i pasur, ka
17 pushtet, apo është i arsimuar, nuk do të thotë se aty ka
18 medoemos edhe virtyt. Por, është tepër e saktë se nga
19 virtytshmit e shekujve që kanë menduar për njeriun, lirinë,
20 drejtësinë dhe mirëqenien e tij, kanë ardhur begatia,
21 humanizmi dhe zhvillimi shoqëror.

22 Luftërat dhe padrejtësitë nuk janë veprat të të
23 virtytshmeve. Por kjo e fundit nuk vlen për luftën për jetë,
24 për liri e për çlirim.

25 Unë z. Gjyqtar, i kam lexuar dokumentet, aktakuzën edhe

1 këtë shtesën e fundit dhe muj me thënë me bindje të plotë se e
2 kam të vështirë ta kuptoj edhe akuzën e parë edhe vazhdimin
3 pasi jam i bindur që vepra të tilla kurrë nuk kam kryer në
4 jetën time.

5 Prandaj, deklarohe me krejtësisht i pafajshëm.

6 Dhe natyrisht kërkojmë që gjyqi të shpejtohet dhe mos na
7 mbajnë kaq gjatë padrejtësisht në paraburgim në Scheveningen
8 të Hagës.

9 Ju faleminderit për vëmendjen.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim]

11 [Nuk ka përkthim 14.12.29 - 14.13.11]

12 ...në një gjuhë që ju e kuptoni për natyrën dhe shkakun e
13 akuzave të ngritura kundër jush.

14 Keni të drejtën të keni kohë dhe mjete të mjaftueshme për
15 përgatitjen e mbrojtjes dhe keni të drejtën të komunikoni me
16 avokatin e zgjedhur prej jush.

17 Keni të drejtën të gjykoheni brenda një kohe të
18 arsyeshme.

19 Keni të drejtën që të gjykoheni në praninë tuaj dhe të
20 mbroheni përmes avokatit.

21 Keni të drejtën që t'ju caktohet një avokat mbrojtës pa
22 pagesë, në qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme për të
23 paguar për të.

24 Keni të drejtën të shqyrtoni ose të pyesni dëshmitarët
25 kundër jush si dhe të jeni -- të ndiqen këta dëshmitarë në

1 praninë tuaj.

2 Keni të drejtën të ndihmoheni nga një përkthyes, në qoftë
3 se nuk e flisni ose nuk e kuptoni gjuhën që përdoret në
4 Gjykatë.

5 Keni të drejtën që të mos detyroheni që të dëshmoni
6 kundër vetes ose që të pranoni fajësinë.

7 Keni të drejtën që të heshtni dhe nuk do të ketë asnjë
8 ndikim negativ që rrjedh nga kjo heshtje.

9 Keni gjithashtu të drejtën që të bëni deklaratë pa betim
10 dhe gjithashtu mund të dilni, mund të shfaqeni si dëshmitar
11 nën betim.

12 Keni të drejtën që të parashtrojmë mocionet paraprake.

13 Keni të drejtën që të merrni materialin mbështesë për
14 aktakuzën e ndryshuar të parashtruar për konfirmim.

15 Keni të drejtë që të merrni të gjitha deklaratat e
16 dëshmitarëve që synon të thërrasë Prokurori i Specializuar për
17 të dhënë dëshmitë e tyre në gjykim, në një gjuhë që ju e
18 kuptoni dhe e flisni, pra në shqip.

19 Keni të drejtë që të merrni informacion menjëherë sa i
20 takon fajësisë suaj apo lehtësimit të fajësisë tuaj dhe keni
21 të drejtë gjithashtu që të merrni të gjithë informacionet që
22 kanë të bëjnë me të dhënat nga Prokurori i specializuar.

23 Keni të drejtë që të merrni materialet dhe provat
24 përkatëse ose faktet në posedim të Prokurorisë së Përgjithshme
25 -- Prokurorisë së Specializuar në fillim dhe gjatë proceseve

1 gjyqësore.

2 Keni të drejtën që të mos --

3 [nuk ka përkthim 14:15.30-14:15:51]

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për çfarëdolloj gjëje që keni
5 thënë nuk kemi përkthim për këtë.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk e di znj. Sekretare
7 nëse mund të kontrolloni nëse ka ndonjë problem teknik apo në
8 qoftë se po flas unë shumë shpejt për përkthimin.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Krasniqi, do i kthehem
10 edhe një herë asaj çfarë po thoja. Ju lutem a e konfirmoni dot
11 që po e merrni përkthimin në shqip tani?

12 I AKUZUARI KRASNIQI: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shumë mirë. Në qoftë se
14 keni ndonjë problem tjetër, ju lutem mos hezitoni të na e
15 thoni. Ju lutem më thoni në mënyrë të tillë që ta zgjidhim
16 problemin përpara se sa të vijojmë më tej.

17 Unë po thoja se ju keni të drejtën që të merrni të gjitha
18 deklaratat e dëshmitarëve që synon të thërrasë Prokuroria e
19 Specializuar në procesin gjyqësor në një gjuhë që ju e kuptoni
20 dhe e flisni.

21 Keni të drejtën që të merrni menjëherë çdo informacion, i
22 cili në mënyrë të arsyeshme mund të sugjerojë pafajësinë tuaj
23 ose mund të lehtësojë fajësinë tuaj ose mund të ndikojë mbi
24 besueshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar sapo ky
25 informacion të jetë nën kujdesin, kontrollin ose njohurinë

1 aktuale të Prokurorisë së Specializuar.

2 Keni të drejtë që të gjitha materialet ose të dhënat
3 përkatëse ose faktet në posedim të Prokurorit të Specializuar
4 t'ju vihen në dispozicion përpara dhe gjatë ose në fillim të
5 proceseve gjyqësore. Kjo e drejtë i nënshtrohet vetëm
6 kufizimeve të cilat janë rreptësisht të nevojshme dhe kur
7 zbatohen masa mbrojtëse kundërbalancuese.

8 Ju keni të drejtën që të mos mbaheni i ndaluar për një
9 periudhë të paarsyeshme përpara hapjes së çështjes. Të kërkonte
10 rishikimin e vendimeve për paraburgimin tuaj dhe që t'i
11 apeloni këto vendime në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën e
12 Apelit.

13 Ju keni të drejtën që të apeloni ose përmes -- ose
14 drejtpërdrejtë ose përmes autorizimit, ashtu siç parashikohet
15 nga Rregullorja.

16 Z. Krasniqi keni dëgjuar të drejtat më të rëndësishme që
17 gëzoni në pajtim me kuadrin ligjor të zbatueshëm. A i kuptuat
18 këto të drejta, z. Krasniqi?

19 Në qoftë se doni që të përsëris sepse nuk dëgjuat një
20 pjesë të përkthimit ju lutem mos hezitoni të ma kërkonte këtë
21 gjë.

22 I AKUZUARI KRASNIQI: Jo nuk kam ç'ka të them. Do të thotë
23 i kam kuptuar. Por dëshiroj që drejtësia të triumfojë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Krasniqi.

25 Tani do t'i kërkoj Sekretares së seancës që të lexojë

1 akuzat e reja të cilat jepet në aktakuzën e ndryshuar të
2 konfirmuar, siç parashikohet në Ligj dhe në Rregullore.

3 Znj. Sekretare, fjala për ju.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
5 nderuar Gjykatës.

6 1. Në aktakuzën e ndryshuar të konfirmuar Prokurori i
7 Specializuar shton akuzat e reja në vijim, kundër z. Krasniqi:

8 a. Në lidhje me krimet që pretendohen të jenë kryer në
9 Budakovë dhe Semetishtë, në komunën e Suharekës, midis
10 afërsisht 4 korrik 1998 dhe shtator 1998 dhe më 28 ose 29
11 prill 1999 ose rreth këtyre datave në lidhje me të paktën 12
12 persona:

13 i. Pika 1: Krimi kundër njerëzimit i përndjekjes i
14 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

15 ii. Pika 2: Krimi kundër njerëzimit i burgosjes i
16 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

17 iii. Pika 3: Krimi i luftës i ndalimit arbitrar i
18 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

19 iv. Pika 4: Krimi kundër njerëzimit i akteve të tjera
20 çnjerëzore i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

21 v. Pika 5: Krimi i luftës i trajtimit mizor i
22 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

23 vi. Pika 6: Krimi kundër njerëzimit i torturës i
24 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

25 vii. Pika 7: Krimi i luftës i torturës i ndëshkueshëm në

1 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

2 viii. Pika 8: Krimi kundër njerëzimit i vrasjes së
3 paligjshme i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;

4 ix. Pika 9: Krimi i luftës i vrasjes së paligjshme i
5 ndëshkueshëm në bazë të nenit 1191)(c)(i) të Ligjit;

6 x. Pika 10: Krimi kundër njerëzimit i zhdukjes me forcë
7 të personave i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(i) të
8 Ligjit;

9 b. Në lidhje me krimet që pretendohet të jenë kryer në
10 Gjilan, komuna e Gjilanit, përsëri në korrik të vitit 1999 në
11 lidhje me të paktën 3 persona:

12 i. Pika 1: Krimi kundër njerëzimit i përndjekjes i
13 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

14 ii. Pika 2: Krimi kundër njerëzimit i burgosjes i
15 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

16 iii. Pika 3. Krimi i luftës i ndalimit arbitrar i
17 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

18 iv. Pika 4. Krimi kundër njerëzimit i akteve të tjera
19 çnjerëzore i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

20 v. Pika 5. Krimi i luftës i trajtimit mizor i
21 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

22 vi. Pika 6. Krimi kundër njerëzimit i torturës i
23 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

24 vii. Pika 7: Krimi i luftës i torturës i ndëshkueshëm në
25 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

1 viii. Pika 8. Krimi kundër njerëzimit i vrasjes së
2 paligjshme i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;
3 dhe

4 ix. Pika 9. Krimi i luftës i vrasjes së paligjshme i
5 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit.

6 2. Krimet në pikat 1, 2, 4, 6, 8 dhe 10 u kryen si pjesë
7 e sulmit gjerësisht të përhapur ose sistematik kundër
8 popullatës civile në Kosovë dhe në Shqipërinë veriore së paku
9 që prej marsit 1998 deri në shtator 1999. Në veçanti këto
10 krime vunë në shënjestër kundërshtarët që konsideroheshin se
11 kishin qenë "bashkëpunëtorë" ose të lidhur me forca zyrtare
12 ose institucione shtetërore të Republikës Federative të
13 Jugosllavisë ("RFJ") ose ndryshe kur mbështesnin qëllimet ose
14 metodat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe më vonë të
15 Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, ndër të cilët persona të
16 lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës apo persona me serb --
17 me kombësi serbe, rome ose persona të kombësive të tjera.

18 3. Pikat 3, -- krimet në pikat 3, 5, 7 dhe 9 u kryen
19 kundër personave që nuk merrnin pjesë aktive në luftime në
20 kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe në
21 lidhje me këtë konflikt ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së
22 dhe Republikës së Serbisë, ndër të cilat, njësitet e Ushtrisë
23 Jugosllave, njësitet policore dhe njësite të tjera të
24 Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupe të tjera që
25 luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë që prej së paku marsit

1 1998 deri afërsisht më 16 shtator 1999.

2 4. Në lidhje me këto krime ekziston një dyshim i bazuar
3 mirë se z. Krasniqi ka përgjegjësi penale në bazë të nenit
4 16(1)(a) të Ligjit për:

5 a. Kryerjen, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të
6 përbashkët të krimeve në pikat nga 1 deri në 10 ose si
7 alternativë për kryerjen, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të
8 përbashkët të sipërpërmendur për krimet në pikat 1-10 duke
9 pasur dijeninë se krime të tilla mund të kryheshin në zbatimin
10 e qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes kriminale të
11 përbashkët dhe duke e marrë përsipër atë rrezik me vullnet të
12 lirë; dhe/ose

13 b. Ndhimën ose inkurajimin e krimeve në pikat 1-10.

14 5. Gjithashtu dhe si alternativë, ekziston dyshimi i
15 bazuar mirë se z. Krasniqi ka përgjegjësi penale si epror në
16 bazë të nenit 16(1)(c) të Ligjit për krimet në pikat 1-10.

17 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Sekretare.

19 Z. Krasniqi dëshiroj t'ju informoj që sot nuk është koha
20 që të kontestohet apo të kundërshton akuzat e reja por thjesht
21 sa për të vërtetuar se i keni kuptuar këto akuza të reja. Do
22 të keni mundësi të shumta që të kundërshtoni akuzat me ndihmën
23 e avokatit.

24 Z. Krasniqi a i kuptuar akuzat e reja të përfshira në
25 aktakuzën e konfirmuar siç u lexuan nga z. Sekretare e

1 seancës?

2 I AKUZUARI KRASNIQI: Akuzat natyrisht që i kuptova unë.
3 Gjuhën shqipe e kuptoj mirë, por unë jam i bindur që asnjë
4 lloj të përgjegjësisë nuk e kam në këtë që e dëgjova, për këtë
5 që e dëgjova.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Krasniqi.

7 Dëshiroj t'ju kujtoj se në përputhje me Ligjin 24(5),
8 25(1) [sipas përkthimit] të Ligjit, ju nuk mund ta përfaqësoni
9 veten sepse jeni aktualisht në paraburgim. Përfaqësimi nga
10 avokati mbrojtës [e pakuptueshme] shumë në rastin tuaj. Unë e
11 di që jeni përfaqësuar nga avokati mbrojtës që në fillim
12 fare, kështu që jam i bindur që i akuzuari përfaqësohet nga
13 avokati mbrojtës.

14 Pra, këto në fakt [e pakuptueshme] megjithatë në mënyrë
15 zyrtare do t'i drejtohem të akuzuarit për t'u deklaruar për
16 fajësinë apo pafajësinë.

17 Z. Krasniqi, brenda 30 ditëve juve t'ju kërkohet që të
18 pranoni fajësinë ose pafajësinë për secilën prej akuzave të
19 shtuara në aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar.

20 Megjithatë, në qoftë se juve dëshironi ta bëni, mund të
21 deklaroheni fajtoj se jofajtor menjëherë.

22 Kështu që do të doja t'ju kërkoja që të thonit në qoftë
23 se keni pasur mundësi që të diskutonit akuzat në aktakuzën e
24 ndryshuar me avokatin tuaj dhe në qoftë se jeni të përgatitur
25 që të vetëdeklaroheni lidhur me fajësinë ose jofajësinë për

1 këto akuzat.

2 I AKUZUARI KRASNIQI: Natyrisht unë kam biseduar me
3 avokaten dhe ekipin e Mbrojtjes. Unë ndjehem krejtësisht i
4 pafajshëm.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Krasniqi.
6 Kjo u mbajt shënim.

7 Në këtë pikë dua t'ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve në
8 qoftë se kanë ndonjë çështje tjetër që duan të ngrenë.

9 Z. Prokuror.

10 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk kemi
11 pyetje.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Avokatja e Viktimave.

13 ZNJ: RADZIEJOWSKA: [Përkthim] E njëjta gjë edhe për neve.
14 Nuk kemi asnjë çështje.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo nuk kemi gjë tjetër për të
17 ngritur.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ky është fundi i seancës së
19 ditës së sotme. I falënderoj palët për praninë e tyre.

20 Këtu përfundon seanca.

21 --- Paraqitja e Mëtejshme përfundon në orën

22 14.29

23

24

25